

Frederik Shalësi

INFORMATIKA 11

bërthamë

LIBËR MËSUESI

**TË MENDUARIT KRITIK DHE STRUKTURA “E.R.R”
E PLANIFIKIMIT TË MËSIMIT
(MODELE MËSIMI)**

botimet
ideart 

Tiranë-2010

Botues: Redin JEGENI

Redaktor letrar: Silvana Leka

Arti grafik: Lindita Dervishi

Kopertina: Parid Teferiçi

© Copyright, IDEART

© Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Riprodhimi i librit, qoftë edhe në formë të pjesëshme, është i ndaluar.

Nuk mund të kopjohet asnjë tekst apo zgjidhje grafike e tij pa lejen dhe miratimin paraprak të IDEART, i cili është mbajtës i vetëm i së drejtës së botimit dhe shpërndarjes së tij, përveç rasteve kur kjo e drejtë lejohet qartazi nga ligji.

Botuesi është i gatshëm t'i ofrojë të drejtat pa pagesë për citimet, përdorimet me qëllim studimi vetiak apo për elementë të veçantë grafikë që gjenden në këtë libër, duke nënshkruar fillimisht marrëveshje për to.

Të drejtat morale të autorëve dhe artistëve që punuan për realizimin e këtij projekti mbrohen nga IDEART, bazuar në legjislacionin shqiptar mbi pronësinë intelektuale dhe të Drejtat e Autorit, Nr. 9380, dt. 28.04.2005 si dhe në konventat, dispozitat dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

Botimi i parë: IDEART, 2010

www.ideartlibri.com

botimet ideart
botime@ideartlibri.com
P.O. BOX 1532, Tiranë (AL)
Tel./Fax: ++ 355 4 2233205

Përmbajtja

5	Plani mësimor Sintetik dhe Analitik
12	Terminologji
13	Taksonomia konjitive e blumit
14	TEMA Funksionet e programit Excel
15	TEMA Njohja me librin e punës
17	TEMA Kuptimi mbi qelizën
19	TEMA Modifikimi i qelizës
20	TEMA Përdorimi i operatorëve aritmetikë. Funksionet e gatshme logjike
22	TEMA Renditja, filtrimi, ruajtja e një fjalëkalimi
23	TEMA Ndërtimi i grafikëve. Formatimi i grafikëve
25	TEMA Formatimi i faqes së punës. Komanda Print Preview,Print
27	TEMA Konceptet bazë të programit Access
29	TEMA Njohja me elementët e Databazës
30	TEMA Krijimi i strukturës së tabelës Databazë
32	TEMA Koncepti dhe krijimi i një forme
33	TEMA Koncepti dhe krijimi i një querie të thjeshtë.
35	TEMA Përgatitja e raporteve
37	TEMA Veprimet kryesore në objektetet e Access, Filtrimi
39	Microsoft access database projekt
40	TEMA Llojet e rrjetave kompjuterike
42	TEMA Lundrimi në Internet
44	TEMA Siguria e punës në Internet
46	TEMA Interneti nëpërmjet linjës telefonike
48	Kuiz

PLANI MËSIMOR SINTETIK DHE ANALITIK

TEKNOLOGJIA 11

E INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT

SHTËPIA BOTUESE “IDEART”

GIJTHSEJ 36 JAVË x 1 ORË/JAVË = 36 ORË
NJOHURI TË REJA 27 ORË
PUNË PRAKTIKE 5 ORË
PROJEKTE 4 ORË

Synimet kryesore të programit për nxënësit e klasës së njëmbëdhjetë janë:

- të sigurojë njohuritë kryesore të nevojshme për të përdorur mjetet dhe pajisjet e teknologjisë dhe informacionit që bashkëpunojnë me kompjuterin;
- të sigurojë njohuritë kryesore të nevojshme për të përdorur aplikimet kryesore të kompjuterit dhe internetin;
- të përdorë disa nga programet bazë të paketës Microsoft Office, duke siguruar njohuritë e nevojshme për certifikim të tyre;
- të demonstrojë dhe shfrytëzojë internetin dhe njohuritë dixhitale;
- të fitojë kulturë pune për të thelluar në mënyrë të pavarur njohuritë në këtë fushë;
- të fitojë bazat e nevojshme për rritjen e mëtejshme të produktivitetit nëpërmjet certifikimit në aplikimet ndërkombëtare.

LINJAT	Sasia e orëve
Microsoft Excel	13 orë
Microsoft Access	10 orë
Përdorimi Internetit	4 orë
Punë praktike	5 orë
Projekte	4 orë
Gjithsej	36 orë

Nr.	Kapitulli I	Tema	Orë	Objektivat kryesore dhe specifike
1.		1. Funksionet e programit Excel	1	<ul style="list-style-type: none"> 1- Të gjejë dhe përshkruajë elementet kryesore të faqes së punës në Versionin 2007 2- Të provojë të kryejë manipulime në faqen e punës duke u bazuar në komandat e reja. 3- Të demonstrojë pavarësi në përdorimin e funksioneve bazë të Excel
2.	Microsoft Excel	2. Njohja me librin e punës	1	<ul style="list-style-type: none"> 1- Të hapë dhe të mbyllë një libër pune të gatshëm në programin Excel 2007 2- Të përdorë variante të ndryshme të librit të punës, template nga programi/ interneti etj. 3- Të krijojë modele të librit të punës duke e ruajtur atë në disa variante dhe të tregojë ndryshimet mes tyre.
3.	Njohuri 13 orë	3. Kuptimi mbi qelizën	1	<ul style="list-style-type: none"> 1- I Të identifikojë qelizën aktive. 2- Të dallojë mënyrat e ndryshme të selektimit të qelizës, rreshtit, kolonës, faqes punës etj. 3- Të plotësojë dhe formatojë një tabelë me tekst dhe numra
4.	Punë praktikë 1 orë	4. Modifikimi i qelizës	1	<ul style="list-style-type: none"> 1- Të identifikojë komandat që shërbejnë për editimin e një qelize. 2- Të ndërtojë tabelë me tekst dhe shifra dhe të editojë të dhënat e saj. 3- Të modifikojë tabelën duke zbatuar konceptet e reja, replace, find etj
5		5. Tabela organizimi i saj.	1	<ul style="list-style-type: none"> 1- Të identifikojë komandat për shtimin, heqjen e rreshtave dhe kolonave. 2- Të përdorë modele tabelasht të gatshme nga programi 3- Të krijojë tabela të njëjta në shumë faqe pune
6		6. Formatimi i tabelës	1	<ul style="list-style-type: none"> 1- Të kuptojë funksionin e komandës Freeze. 2- Të formatojë tabelën sipas kriterëve të përcaktuara nga mësuesi. 3- Të përgatitë tabela në mënyrë të pavarur.

7-8	7-8. Përdorimi i operatorëve aritmetikë Funksionet e gatshme logjike	2	1- Të identifikojë operatorët aritmetikë dhe të kryejë veprime matematike përmes funksioneve të gatshme . 2- Të ndërtojë formula duke përdorur të gjithë operatorët aritmetikë dhe funksionet e gatshme që ofron programi. 3- Të aplikojë në mënyrë të pavarur funksionet logjike që ofron programi Microsoft Excel, për të zgjidhur probleme të fushave të ndryshme (Statistikë, Matematikë dhe Trigonometri) etj.
9	9. Punë praktike (Organizimi i të dhënave në formë tabelë- Bilanci, formatimi i saj)	1	1- Të ndërtojë një tabelë në formën e bilancit sipas modelit të tekstit. 2- Të krijojë një bilanc origjinal në përmbajtje dhe formë.
10	Microsoft Excel 10. Projekt (Plotësimi i tabelës -Bilanc)	1	1- Të plotësojë në mënyrë të saktë të dhënat e një tabele bilanci. 2- Të pasqyrojë në tabelën bilanc zbatimin e të gjitha komandave të mësuara në Excel.
11	11. Renditja, filtrimi, ruajtja me një fjalëkalim	1	1- Të identifikojë komandat që realizojnë renditjen, filtrimin dhe ruajtjen me një fjalëkalim. 2- Të aplikojë komandat e reja duke u mbështetur në udhëzimet e mësuara. 3- Të nxjerrë të dhënat e kërkuara duke zbatuar në mënyrë të pavarur konceptet e reja.
12-13	12-13. Ndërtimi i grafikëve. Formatimi i grafikëve	2	1- Të identifikojë pjesët përbërëse të një grafiku dhe të provojë të ndërtojë grafikë me ndihmën e modeleve të gatshme. 2- Të përdorë të dhënat e nxjerra në një tabelë Exceli për të ndërtuar grafikë të llojeve të ndryshme në varësi të kriterëve të përcaktuara nga mësuesi. 3- Të krijojë grafikë në mënyrë të pavarur, duke pasqyruar gjithë elementët përbërës të tij, me shpëgimet përkatëse.

14-15		14-15. Formatimi i faqes së punës. Komanda Print Preview, Print	2	1- Të identifikojë elementët kryesorë që realizojnë printimin e një materiali në programin Microsoft Excel. 2- Të printojë një material të punuar në Microsoft Excel, duke zbatuar komandat edhe udhëzimet e dhëna nga mësuesi. 3- Të printojë në mënyrë të pavarur një punim të plotë në Microsoft Excel dhe të shpjegojë qartë procedurën e ndjekur.
16		16. Projekt (Vendosja dhe zbatimi i formulave në Tabelën -Bilanc)	1	1- Të përdorë operatorët arimetikë dhe formulat e gatshme për të nxjerrë të dhëat e bilancit.
Nr	Kapitulli II	Tema	Orë	Objektivat kryesore dhe specifike
17	Microsoft Access	17. Konceptet bazë të programit Access.	1	1- Të kuptojë rëndësinë e organizimit të të dhënave në një databazë. 2- Të dallojë fushat sipas llojit të tipit të të dhënave që mbartin. 3- Të veçojë nga tërësia e të dhënave çelësin primar.
18		18. Njohja me elementët e Databazës	1	1- Të aktivizojë dritaren e punës për krijimin e një databaze dhe të identifikojë elementët kryesorë të saj. 2- Të organizojë fushat duke pasur parasysh përpunimet dhe rezultatit që do të marr prej tyre. 3- Të kompozojë një mini-databazë në mënyrë të pavarur duke respektuar të gjithë kriteret e përcaktuara nga mësuesi.
19-20	Punë Praktike 1 orë Projekt 2 orë	19-20. Krijimi i strukturës së tabelës Databazë. Rregjistrimi i të dhënave në tabelë	2	1- Të identifikojë elementët e strukturës së bazës së të dhënave. 2- Të modifikojë strukturën e bazës së të dhënave. 1- Të organizojë në mënyrë të pavarur një bazë të dhënash
21		21. Punë praktike Krijimi i tabelës Student, Kurs		1- Të krijojë tabelë në Access bazuar në të dhënat e përcaktuara nga mësuesi. 2- Të organizojë të dhënat në mënyrë origjinale dhe të pavarur.

22	22. Koncepti dhe krijimi i një forme	I	<p>1- Të identifikojë llojet të ndryshme të formave (columnar, tabular, datasheet).</p> <p>2- Të dallojë format për nga avantazhet që ofrojnë në përdorim.</p> <p>3- Të realizojë në mënyrë të pavarur regjistrimin e një grupi të dhënash një një prej formave që ofron programi.</p>
23-24	23-24 Koncepti dhe krijimi i një querie të thjeshtë. Krijimi i Querive me disa skedarë	2	<p>1- Të krijojë queri të thjeshta mbështetur në të dhënat e tabelave të krijuara në orët e mëparshme.</p> <p>2- Të aplikojë në ndërtimin e querve kritere komplekse për marrjen e informacionit të shumëllojshëm.</p> <p>3- Të kompozojë në mënyrë të pavarur queri, duke përdorur kombinime të kritereve të ndryshme, bazuar në fushat e të dhënave, që kërkojnë zbatimin e sintaksave të ndryshme.</p>
25	Microsoft Access	I	<p>1- Të identifikojë raportet si një mjet shumë i rëndësishëm për nxjerrjen e informacionit nga programi Microsoft Access.</p> <p>2- Të përdorë raporte në mënyrë që të bëjë një paraqitje sa më tërheqëse dhe estetike të informacionit të përpunuar në Microsoft Access.</p> <p>3- Të hartojë në mënyrë të pavarur raporte bazuar në tabelat ose queri, duke shfrytëzuar punët e krijuara në mënyrë vetjake.</p>
26	26. Veprimet kryesore në objektet e Access, Filtrimi.	I	<p>1- Të veçojë disa nga veprimet kryesore në objektet e Microsoft Access.</p> <p>2- Të kryejë në përshatje me informacionin që synon të evidentojë disa prej veprimeve kryesore në objektet e Access.</p> <p>3- Të zbatojë në mënyrë të pavarur kritere të ndryshme renditje.</p>
27	27. Përgatitja për Printim.	I	<p>1- Të bëjë gati për printim duke ndjekur procedurën e nevojshme, materialet e përgatitura në programin Microsoft Access.</p>
28	28. Projekt Studim Rasti	I	<p>1- Të kryejë përpunim të dhënash nga databaza e krijuar në mënyrë vetjake.</p>
29	29. Projekt Studim Rasti	I	<p>1- Të studiojë bazën e të dhënave për të nxjerrë përfundime mbi bazën e kritereve të caktuara.</p>

Nr	Kapitulli III	Tema	Orë	Objektivat kryesore dhe
30		30. Llojet e rrjetave kompjuterikë.	I	1- Të identifikojë dhe të përshkruajë terminologjinë e networkut bazuar në të përbashkëtat e dhe dallimet mes tyre. 2- Të klasifikojë llojet e rrjetave duke i referuar karakteristikave të ndërtimit të tyre. 3- Të njerrë përfundime vetjake mbi kuptimin e intranetit dhe ekstranetit.
31	Përdorimi i Internetit	31. Lundrimi në Internet	I	1- Të njohë dhe të diskutojë rreth historikut të lindjes dhe përdorimit të Internetit. 2- Të listojë dhe shpjegojë elementët mbi të cilët ndërtohet WWW. 3- Të lundrojë në mënyrë të pavarur në Internet duke sjellë informacion mbi motorët e kërkimit, postën elektronike etj.
32	Njohuri 4 orë	32. Punë Praktike (Krijimi i një adrese e-mail)	I	1- Të dërgojë dhe të marrë mesazhe përmes postës elektronike 2- Të përdorë në mënyrë të pavarur postën elektronike
33	Punë Praktike 3 orë	33. Punë Praktike (Bashkëngjitja e mesazheve, filtrimi)	I	1- Të bashkangjitë skedarë të ndryshëm në një email. 2- Të filtrojë sipas rëndësisë dhe përdorimit e-mailit vetjake.
34		34. Siguria e punës në Internet	I	1- Të identifikojë dhe të klasifikojë disa prej standarteve që sigurojnë punën në Internet. 2- Të përdorë opsionet që e bëjnë punën e tij në internet të sigurt nga faqet e pakontrolluara dhe pirate. 3- Të konfigurujë në mënyrë të pavarur opsionin Family Safety Control Panel duke vendosur ndalime të ndryshme etj .
35		35. Interneti nëpërmjet linjës telefonike	I	1- Të kuptojë dhe të shpjegojë funksionin e modemit për të siguruar një lidhje në internet duke shrytëzuar linjën telefonike. 2- Të përshkruajë procedurën e hyrjes së internetit përmes linjës telefonike. 3- Të realizojë në mënyrë të pavarur lidhjen në internet të një rrjeti LAN (2-4 kompjutera)
36		36. Punë Praktike (Krijimi i një llogarie interneti me telefon)	I	1- Të provojë të krijojë një llogari interneti duke përdorur linjën telefonike. 2- Të konfigurujë në mënyrë të pavarur një llogari interneti.

I. TERMINOLOGJI

- **Arritje (performancë)**
- **Objektiva të përmbajtjes**
- **Objektiva të arritjeve**
- **Objektiva të arritjeve të një kapitulli (linje)**
- **Objekte dhe veprimtari**
- **Objektiva specifike**
- **Veprimtari të vëzhgueshme, të demonstrueshme**
- **Kusht, kriter**
- **Nivelet e arritjeve**
- **Niveli bazë, mesatar dhe i lartë**
- **Niveli minimal**
- **Nënobjektiva**
- **Kompetencë**

I. Arritja

Ky term (që ka zëvendësuar termin **performancë**) përdoret për të treguar:

- dije
- shprehi
- qëndrime

që nxënësi i demonstroi (i shfaq) në formën e veprimtarive dhe sjelljeve të ndryshme që kryen, të cilat janë të vëzhgueshme nga mësuesi dhe nxënësit e tjerë, madje, shpesh herë, edhe të matshme.

Në hartimin e synimeve të niveleve të ndryshme, arritja e nxënësve (performanca) fillon të përshkruhet më konkretisht sapo kalohet nga qëllimet, të objektivat e kapitujve, që janë **objektiva të përgjithshme të përmbajtjes**, veçse deri këtu arritja akoma nuk është plotësisht konkrete. Kur hartohen **objektivat specifike** (për **objekte** të caktuara mësimore), arritja e **demonstrueshme** bëhet e përcaktuar plotësisht, madje tani tregohen edhe **kushtet** në të cilat ajo pritët të shfaqet, si dhe **kriteret** e saktësisë së përmbushjes (plotësimi) të arritjes së synuar. Për të përmbushur objektivat specifike, nxënësit i jepen detyra konkrete për të plotësuar, në një sasi dhe renditje që përzgjidhen nga mësuesi.

Objektivat e arritjes- Përkufizimi

Objektivat e arritjeve të një kapitulli, përbëjnë bashkësinë e të gjitha objektivave specifike të hartuara për të gjitha objektet e kapitullit, ose linjës, të ndarë në tri nivele, duke u nisur nga objektivat e programit, ose nga standardet (nëse ka të tilla për lëndën).

2. Nivelet e arritjeve

- **Niveli bazë, mesatar dhe i lartë**

Përsa i përket hierarkisë së arritjeve të nxënësve, do të ruajmë terminologjinë e përdorur të standardet:

- niveli **bazë** (më i ulëti) i arritjeve. Njohja dhe të kuptuarit
- niveli **mesatar**. Klasifikimi dhe krahasimi
- niveli i **lartë**. Krijimi individual dhe kombinimi ideve

TAKSONOMIA KONJITIVE E BLUMIT

Tri nivelet e arritjeve	Nivelet e Blumit	Foljet përshkruese
Niveli bazë	1. Të njohurit Është riprodhimi i një diçkaje pa shpjegime dhe pa e lidhur me gjë tjetër. Përsëritje e emrave, rregullave, përkufizimeve dhe shpjegimeve ashtu siç janë dhënë. Është niveli më i ulët i rezultateve të nxënësve në fushën e njohjes.	Përkufizo, përsërit, përshkruaj me fjalët e tekstit, identifikoj, vër në tabelë, hartoj një listë, emërtoj, riprodho etj.
	2. Të kuptuarit Është aftësia për të kapur kuptimin e materialit. Është baza e fushës së njohjes, një hap më tej se TË NJOHURIT.	Shpjego, zgjero, jep shembuj të tjerë, nxirr përfundime, perfrazoj, rishkruaj, përgjithëso, interpretoj ndryshe, nxirr një përfundim etj.
Niveli mesatar	3. Zbatimi: Është aftësia për të përdorur materialin e mësuar në situata të reja dhe konkrete. Zbatohen rregulla, metoda, koncepte, parime, ligje dhe teori.	Ta aplikosh (zbatosh), të shfrytëzosh, të ndryshosh, të njehsosh, të klasifikosh, të provosh, të vësh në dukje, të manipulosh. Përgatit, lidh, tregoj, shpjego, përdor etj.
	4. Analiza: Është aftësia për ta copëtuar materialin në pjesë përbërëse, ç'ka sjell një kuptim më të mirë të organizimit të tij. Meqenëse krahas përmbajtjes kuptohet edhe forma organizative e materialit, niveli intelektual është më i lartë se në TË KUPTUARIT.	Copëtoj, ndaj në pjesë, shpjego përse, diferencoj, shquaj, dallo, vër në dukje, lidh, seleksionoj etj.
Niveli i lartë	5. Sintezja: Është aftësia që formon një të tërë duke bashkuar pjesët. Mund të jetë: komunikim i një plani veprimesh, klasifikim informacioni etj.	Kombinoj, hartoj, krijoj, zgjidh (një problem që ka shumë rrugë), kompozoj, jep mendime, përmirësoj, organizoj, planifikoj, risistemoj, të shkruash, të tregosh, të prodhosh, të hartosh, të transmetosh, të krijosh, të propozosh, të planifikosh, të prodhosh, të modifikosh, të specifikosh, të kombinosh, të organizosh, të sintetizosh, të klasifikosh, të përfundosh, të zhvillosh, të modifikosh, të ndërtoj etj.
	6. Vlerësimi: Është aftësia për të gjykuar vlerën e një materiali, të mirën e një ideje, motivet e sjelljeve, vlerësimin e zgjidhjeve të problemit, ndërtimin e komunikimeve gjyquese etj.	Krahasoj, konkludoj, vër në kontrast, kritikoj, përshkruaj, shpjego, justifikoj, interpretoj, lidh, përmbledhoj, bëj një evidencë etj.

Sipas kësaj table mund të gjendet se i çfarë niveli është një objektiv i programit. Për këtë, mjafton që të shikosh se cila është folja përshkruese e objektivit dhe ta gjesh këtë folje në shtyllën e tretë të tabelës; në të majtë të saj është niveli përkatës.

LËNDA: Informatikë I I

TEMA: Funkzionet e programit Excel

Kohëzgjatja: I orë

Vendi i zhvillimit: Laborator

Qëllimi i orës së mësimit:

- Familjarizimi nxënësve me versionin Excel 2007

Objektivat: Në përfundim të orës së mësimit nxënësi të jetë i aftë:

1. Të gjejë dhe përshkruajë elementet kryesore të faqes së punës në Versionin 2007.
2. Të provojë të kryejë manipulime në faqen e punës duke u bazuar në komandat e reja.
3. Të demonstrojë pavarësi në përdorimin e funksioneve bazë të Excel.

Mjetet e nevojshme: Kompjuter, Microsoft Excel 2007, Projektor.

Metoda : E/E/R

Hapi i parë: Evokim

U kërkohet nxënësve të hapin në kompjuterin e tyre faqen e punës në programin Microsoft Excel, Versioni 2007.

Mësuesi shfaq në projektor këtë version dhe duke aktivizuar nxënës të ndryshëm bën një përshkrim të faqes së punës, si dhe toolbarëve të menisë kryesore.

Gjatë përshkrimit mësuesi kërkon nga nxënësi të evidentojë ndryshimet me versionin Excel 2003.

Hapi i dytë: Realizmi i kuptimit

- Koncepte të reja: Shtim dhe fshirje e faqes së punës.
- Mësuesi fillimisht shkruan në tabelë komandat me anë të të cilave mund të realizojmë manipulimet e përmendura.
- Insert Sheet, ose Shift+ F11 nga tastiera.
- Delete Sheet, ose klik me buton e djathtë të mausit dhe Delete.
- CTRL + klik në emërtim- për të selektuar të gjithë faqet e punës të librit.
- Mësuesi demonstroi veprime konkrete me secilën nga komandat.
- Nxënësit përsëritin në drejtimin e mësuesit zbatimin e komandave.

Reflektimi: Punë e pavarur

Mësuesi kërkon që nxënësi të shtojë 2 faqe pune dhe një prej tyre ta fshijë, duke zbatuar komandat e mësipërme.

Të gjitha veprimet e kryera nga nxënësit mësuesi i monitoron.

Vlerësimi:

Niveli i lartë: Kur nxënësi demonstroi pavarësi të plotë në përdorimin e funksioneve të mësuara.

Niveli mesatar: Kur nxënësi ka njohuri të mjaftueshme mbi funksionet, por nuk arrin t'i përfundojë në mënyrë të pavarur ato.

Niveli bazë: Kur nxënësi zbaton disa prej komandave me ndihmën e vazhdueshme të mësuesit.

LËNDA: Informatikë I I

TEMA: Njohja me librin e punës

Kohëzgjatja: 1 orë

Vendi i zhvillimit: Laborator

Qëllimi i orës së mësimit:

- Përdorimi i librit të punës për të krijuar dokumentacion me qëllime profesionale (p.sh., bilanc).

Objektivat: Në përfundim të orës së mësimit nxënësi të jetë i aftë:

1. Të hapë dhe të mbyllë një libër pune të gatshëm në programin Excel 2007.
2. Të përdorë variante të ndryshme të librit të punës, template nga programi/interneti etj.
3. Të krijojë modele të librit të punës duke e ruajtur atë në disa variante dhe të tregojë ndryshimet mes tyre.

Mjetet e nevojshme: Kompjuter, Microsoft Excel 2007, Projektor.

Fjalë kyç: Libër pune

Hapi i parë: Diskutim

- Çfarë përfaqëson një libër pune në Excel?
- Mësuesi shënon në tabelë të gjitha variantet e përgjigjeve të dhëna nga nxënësit.
- Në përfundim, kur nuk ka më mendime të reja, mësuesi mund të zgjedhë 2-3 përgjigje që i janë afruar më saktë kuptimit të një libri pune në Excel.

Hapi i dytë: Demonstrim i njohurive të reja

- a. Mësuesi shfaq me projektor një Libër pune të përgatitur nga ai më parë.
- b. Bën dallimim mes koncepteve: **WORKBOOK - WORKSHEET.**
- c. **Përkufizimin e këtyre koncepteve, mësuesi duhet të synojë ta nxjerrë nga nxënësit, duke u nisur nga dijet paraprake. Ai shkruan në tabelë përkufizimin e saktë, vetëm kur kanë shteruar të gjitha idetë e nxënësve.**

Book I - shfaqet automatikisht sapo hapet programi Microsoft Excel dhe përfaqëson një Libër pune me tri faqe. Në këtë fazë mësuesi bën dallimin edhe grafiksht të dy koncepteve të trajtuara më lart

- d. Mund të hapim një Libër pune të krijuar më parë dhe të emërtuar - p.sh., Bilanci.
- e. Mund të hapim një Libër pune të ri me komandën - New.
- f. Të gjitha rastet mësuesi i demonstroi në mënyrë praktike.
- g. Kërkon nga nxënësit të zbatojnë të gjitha komandat e dhëna në kompjuterat e tyre.
- h. Kontrollon nëse janë realizuar sakt komandat.
- i. Demonstron nga mësuesi rezervimi i Librit të punës.

Hapi i tretë: Punë e pavarur

Mësuesi u kërkon nxënësve të krijojnë një libër pune me 12 faqe.

Libri duhet të ruhet në të dy versionet 2003/2007.

Nxënësit duhet të përdorin gjithashtu për rezervim komandën Save As - mësuesi duhet të kërkojë që nxënësi të jetë në gjendje të shpjegojë ku qëndron dallimi me komandën Save.

Gjithashtu nxënësi duhet ta ruajë materialin e punuar edhe në variantin Web Page.

Për secilën nga kërkesat e mësipërme, mësuesi fton për demonstrim përpara klasës nxënës të ndryshëm.

Në këtë fazë të mësimit, mësuesi jo vetëm kontrollon njohuritë, por përforcon ato koncepte, që dalin të paqarta.

Vlerësimi:

Nivel i lartë: Ka krijuar Librin e punës me të gjitha faqet e nevojshme. E ka ruajtuar në disa variante. Është në gjendje të japë ndryshimet mes tyre

Niveli i mesëm: Ka krijuar Librin e punës në bazë të kërkesave. E ka ruajtur por jo, në të gjitha variantet e kërkuara.

Niveli bazë: Ka krijuar Librin e punës. Nuk është në gjendje të përdorë larmishmërinë e varianteve të ruajtjes së tij.

LËNDA: Informatikë I I
TEMA: Kuptimi mbi qelizën

Kohëzgjatja: 1 orë

Vendi i zhvillimit: Laborator

Objektivat: Në përfundim të orës së mësimit nxënësi të jetë i aftë:

1. Të identifikojë qelizën aktive.
2. Të dallojë mënyrat e ndryshme të selektimit të qelizës, rreshtit, kolonës, faqes së punës etj.
3. Të plotësojë dhe formatojë një tabelë me tekst dhe numra.

Mjetet e nevojshme: Kompjuter, Microsoft Excel 2007, Projektor.

Fjalë kyç: Qelizë aktive, Selektim, Formatim.

Hapi i parë: Insert

- Koncepti i qelizës është një koncept i marrë edhe më parë.
- Mësuesi shfaq në projektor një faqe Exceli në cilin me anë të shigjetave ose me komente ka veçuar në formën e qelizës së zgjedhur p.sh., A1, F7 etj.
- Në tabelë nxënësi vendos sipas rubrikave ide në lidhje me paraqitjen e dhënë në projektor.

E di	E panjohur	E paqartë
Si formohet një qelizë	RANG	

Hapi i dytë: Demonstrim i njohurive të reja

SELEKTIMI I QELIZAVE

- Mënyra e parë - Me ndihmë e Mausit, pozicionohemi me të në formën e plusit në qelizën ku do të fillojmë selektimin. Duke e mbajtur të shtypur butonin e majtë të mausit zhvendosemi me të deri në fund të **RANGUT**.
- Mënyra e dytë - Klikojmë te qeliza e parë e rangut që duam të selektojmë, shtypim Shift dhe e mbajmë të shtypur. Klikojmë te qeliza e fundit e **RANGUT**.
- Mësuesi kërkon nga nxënësit të përsëritin veprimet sipas komandave që ai jep.
- Nuk duhet të kalohet në koncepte të reja, pa përvetësuar mënyrat e selektimit.

SELEKTIMI I RRESHTIT, KOLONAVE, FAQES SË PUNËS, APO PJESËVE TË SHKËPUTURA TË SAJ

Hapi i tretë: Punë e udhëhequr

1. U jepen nxënësve disa të dhëna dhe u këkohet të vendosen në tabelë sipas modelit që mësuesi ka projektuar.
2. Plotësimi i tabelës duhet të jetë i kombinuar me tekst dhe shifra.
3. Kalohet në formatimin unik të tabelës sipas kritereve të mësuesit, që duhet t'i paraqisë të listuara në tabelë, sipas rradhës së veprimeve: lloji shkrimit, madhësia e tij, pozicionimi në tabelle, përdorimi ose jo i numrave dhjetorë etj.

4. Mësuesi e monitoron të gjithë veprimtarinë. Ndërhyn dhe e demonstron vetë atë pjesë të veprimeve që nuk e realizon dot më tepër se 50% e nxënësve.
5. Nxënësi që përfundon të gjithë procedurën nën monitorimin e mësuesit, mund të demonstrojë punën e tij në tabelë.

Vlerësimi:

Niveli i lartë: Selektion, plotëson dhe formaton tabelën në mënyrë të pavarur.

Niveli i mesëm: Selektion, plotëson dhe formaton tabelën me ndihmën e mësuesit.

Nivel bazë: Selektion dhe plotëson tabelën me ndihmën e mësuesit.

LËNDA: Informatikë I I

TEMA: Modifikimi i qelizës

Vendi i zhvillimit: Laborator

Objektivat: Në fund të orës së mësimit nxënësi të jetë i aftë:

1. Të identifikojë komandat që shërbejnë për editimin e një qelize.
2. Të ndërtojë tabelë me tekst dhe shifra dhe të editojë të dhënat e saj.
3. Të modifikojë tabelën duke zbatuar konceptet e reja, replace, find etj

Mjetet e nevojshme: Kompjuter, Programi Microsoft Excel 2007, Projektor.

Fjalë kyç: Search, Find, Replace.

Bashkëbisedim 10 minuta

Mësuesi shfaq me ndihmën e projektorit dy tabela një me të dhëna, tjetrën të paplotësuar të punuara nga nxënësit.

Mësuesi u këkon nxënësve të listojnë komandat më të përdorshme, për të bërë një ndryshim të materialit të tabelës së punuar prej tij:

- a. Cut
- b. Copy
- c. Paste

Në këtë fazë të orës së mësimit rikujtohen njohuritë e marra më parë.

Nxënësi duhet t'i kryejë vetë veprimet në faqen e punës.

Veprimtari e udhëhequr nga mësuesi

- Paraqitet me ndihmën e projektorit një tabelë me tekst.
- Mësuesi kërkon nga nxënësit të veçojnë atë element të tekstit që dallon nga të tjerët.
- Duhet të evidentohet përdorimi i “w” si mjet zëvendësimi për gërmën “ë” të gjuhës shqipe.
- Mësuesi shpjegon fillimisht se çfarë mund të realizojmë përmes seksionit Editing.
- Dy komandat më të rëndësishme për këtë mësim janë: **Find dhe Replace**.
- Mësuesi demonstron përdorimin e tyre.
- I jepet nxënësit detyrë që të krijojë një tabelë me tekst dhe të bëjë zëvendësimin e “w”.
- Gjithashtu i kërkohet që me ndihmën e komandës Find, të gjejë një të dhënë në faqen e punës.

Detyrë shtëpie:

Të krijohet një tabelë dhe të modifikohet me ndihmën e komandave të reja.

Të përshkruhen në fletore hapat e ndjekura për realizimin e modifikimeve.

LËNDA: Informatikë I I

TEMA: Përdorimi i operatorëve aritmetikë. Funkzionet e gatshme logjike.

Koha e zhvillimit: 2 orë

Vendi i zhvillimit: Laborator

Qëllimi i orës së mësim:

- Aftësimi në përdorimin e operatorëve aritmetikë dhe funksioneve të gatshme në programin Microsoft Excel.

Objektivat: Në fund të orës së mësimit nxënësi të jetë i aftë:

1. Të identifikojë operatorët aritmetikë dhe të kryejë veprime matematike përmes funksioneve të gatshme.
2. Të ndërtojë formula duke përdorur të gjithë operatorët aritmetikë dhe funksionet e gatshme që ofron programi.
3. Të përdorë në mënyrë të pavarur, funksionet logjike që ofron programi Microsoft Excel për zgjidhjen e problemeve të fushave të ndryshme (Statistikë, Matematikë dhe Trigonometri) etj.

Mjetet e nevojshme: Kompjuter, Programi Microsoft Excel 2007, Projektor, Miniteste.

Fjalë kyç: Operatorë aritmetikë, Funksione të gatshme.

Hapi i parë: Prezantim i koncepteve të reja

- Cilat janë rregullat bazë të shkrimit të saktë të një formule, për të na dhënë rezultatin e kërkuar?
- Demonstrimi operatorëve aritmetikë.
- Rradha e veprimeve. (veprimet në kllapë kanë gjithmonë parësi)
- Demonstrimi i funksioneve të gatshme: **SHUMË, MESATARE ARITMETIKE, PËRQINDJE etj.**
- Dallimi i të njëjtit funksion : SHUMË DHE AUTOSHUMË.
- Funksionet e tjera më të përdorshme: NUMËRIM, VLERA MINIMALE DHE MAKSIMALE etj.

Hapi i dytë: Punë e pavarur

Mësuesi jep tre ushtrime dhe kërkon të gjenden tri elementët më të përdorshëm, SHUMA, MESATARJA ARITMETIKE si dhe PËRQINDJA.

Të dhënat në tabelë janë të gatshme, nxënësi duhet të realizojë vetëm veprimet me operatorët aritmetikë duke përdorur formulat e gatshme.

Për shumën, për nxënësit e avancuar, mësuesi mund të kërkojë edhe gjetjen e Shumës tridimensionale.

Hapi i tretë: Punë e udhëhequr

Funksionet e prezantuara në orën e parë të mësimit nga mësuesi dhe të zbatuara nga nxënësi kanë vlerë llogaritëse.

Programi Microsoft Excel ka edhe funksione logjike.

- a. Shpjegim i konceptit: I VËRTETË/ FALS
- b. Në dallim nga funksionet llogaritëse, funksionet logjike përdorin sintaksën.
- c. Çdo të thotë SINTAKSË: Të përdorësh shprehje të caktuara për të pasur një funksion, p.sh., **IF**

- d. Kalimi i formulave nga një faqe pune te tjetra.
- e. Rrugët që ndjekim për të kopjuar një formulë.

Të gjitha hapat e treguar nga mësuesi përmes demonstrimit praktik, duhet të zbatohen nga nxënësit në faqen e tyre të punës në kompjuter.

Nxënësi duhet të mbajë shënim të gjitha veprimet që kryen, komandat e zbatuara, për të qenë në gjendje të bëj përshkrimin e tyre.


Detyrë shtëpie:

Krijimi i një tabele me emrat e nxënësve të klasës. Plotësimi i saj me rezultatet e testimit të fundit në lëndën e Informatikës.

Gjetja e notës mesatare, përqindjes. Për nxënësit e nivelit të lartë, përdorimi i funksionit IF, si dhe kopjimi i formulave në një faqe të re Exceli.

MINITEST

1. Çfarë tipi grafiku është përdorur në këtë figurë?
 - a. Column
 - b. Bar
 - c. Line
 - d. Pie




2. Nëse në një qelizë shkruani formulën =B38 dhe e kopjoni në një qelizë tjetër do të thotë se:
 - a. Përmbajtja e kolonës fiksohet. - (e sakta)
 - b. Përmbajtja e rreshtit fiksohet.
 - c. Përmbajtja e kolonës dhe rreshtit fiksohen.
 - d. Nuk fiksohet përmbajtja as e rreshtit as e kolonës.

3. Cila është formula që duhet shkruar në qelizën C5 dhe të kopjohet në qelizat C6 : C8? (Në rreshtin 2 është këmbimi i dollarit kanadez me dollarin amerikan)

- a. = \$C2/B5
- b. = \$C\$2/B5 - (e sakta)
- c. = C2/\$B\$5
- d. = C2/B\$5

Çfarë formatimi duket kryer në kolonën C?

	A	B	C
1	Ekivalentim monedhash		
2	Kanada	1	\$1,000.00
3			
4	Shtete	Tarifa	Totali
5	Angli	2.36	£423.73
6	SHBA	1.3	\$769.23
7	Europë	1.83	546.45 €
8	Japoni	0.0121	¥82,644.60
9			

4. Butoni  tregon:
 - a. Korrigjim automatik
 - b. Formatim automatik
 - c. Shumë automatike
 - d. Paraqitje automatike

LËNDA: Informatikë I I

TEMA: Renditja, filtrimi, ruajtja me një fjalëkalim.

Vendi i zhvillimit: Laborator

Objektivat: Në fund të orës së mësimit nxënësi të jetë i aftë:

1. Të identifikojë komandat që realizojnë renditjen, filtrimin dhe ruajtjen me një fjalëkalim.
2. Të aplikojë komandat e reja duke u mbështetur në udhëzimet e mësuesit.
3. Të nxjerrë të dhënat e kërkuara duke zbatuar në mënyrë të pavaruar konceptet e reja.

Mjetet e nevojshme: Kompjuter, Programi Microsoft Excel 2007, Projektor.

Fjalë kyç: Renditje, Filtrim.

Hapi i parë: Prezantim i koncepteve të reja

- Mësuesi paraqet të projektuar një tabelë me emrat e nxënësve të klasës ku është duke zhvilluar mësimin. Emrat në tabelë nuk duhet të jenë të renditur në rendin e tyre alfabetik.
- Pyetja që shtron mësuesi është pikërisht kjo: Si mund t'i renditim sipas alfabetit me ndihmën e programit Microsoft Excel.
- Veçoritë e komandës **Rendit (Sort)**, janë rendijte në rend zbritës dhe ngjitës.
- Tregohet grafikisht A/Z dhe e kundërta Z/A.
- Mësuesi kërkon që nxënësit të përsëritin të njëjtin veprim në postet e tyre të punës.
- Një element tjetër i pasqyruar në tabelë janë notat e marra në testim.
- Mësuesi do të identifikojë sa prej nxënësve kanë marrë rezultat maksimal, notën 10?
- Komanda që i vjen në ndihmë është **Data→Filter (Filtro)**. Notat janë të renditura nga 10 deri në 4 dhe do të veçojmë vetëm emrat me notën 10-të.
- Të njëjtën veprimtari praktike e kryejnë edhe nxënësit, por tani duke ndryshuar kriterin, duke Filtruar në kolonën e mungesave, për të nxjerrë se cilët nxënës nuk kanë qenë të pranishëm në mësim.
- **Ky është një model tabelle ku nxënësit mund të ushtrohen, por mësuesi mund të japë sipas imagjinatës çfarëdo lloj tjetër tabelle dhe përpunimi.**

Hapi i dytë: Punë e udhëhequr

Mësuesi nxit nxënësit të diskutojnë rreth konceptit fjalëkalim.

Përse shërben ai?

Rikujtohen njohuritë e marra për të mbrojtur një material në programin Microsoft Word.

Me ndihmën e projektorit tabela e punuar më parë nga nxënësit rishfaqet e përfunduar me të gjitha të dhënat e saj në tabelë.

Në toolbar mësuesi veçon menunë Review, Protect Sheet (Mbro faqen e punës)

Përpara se të kalojë në veprimin e ardhshëm, mësuesi duhet të sigurohet se çdo nxënës e ka identifikuar këtë ikonë.

Meqë programi jep shumë variante procesesh që mund të bllokohen për përdoruesit e tjerë, mësuesi me shfaqjen e tyre duhet të bëjë një demonstrim për secilin opsion, që nxënësi të shohë praktikisht se cili element sigurohet nga përdorimi i fjalëkalimit.

Është e nevojshme që mësuesi të bëjë dallimin mes një faqeje pune të mbrojtur plotësisht dhe një faqeje pune që mund ta lexojmë (Ready only), por s'mund ta modifikojmë.

Hapi i tretë: Punë e pavarur

Vendosni fjalëkalim për faqen tuaj të punës në të dyja mënyrat.

Variantin Ready only nxënësit duhet ta dërgojnë në adresën e mësuesit.

LËNDA: Informatikë I I

TEMA: Ndërtimi i grafikëve. Formatimi i grafikëve.

Koha e zhvillimit: 2orë

Vendi i zhvillimit: Laborator

Objektivat: Në fund të orës së mësimit nxënësi të jetë i aftë:

1. Të identifikojë pjesët përbërës të një grafiku dhe të provojë të ndërtojë grafikë me ndihmën e modeleve të gatshme.
2. Të përdorë të dhënat e nxjerra në një tabelë Exceli për të ndërtuar grafikë të llojeve të ndryshme në varësi të kritereve të përcaktuara nga mësuesi.
3. Të krijojë grafikë në mënyrë të pavarur, duke pasqyruar gjithë elementët përbërës të tij, me shpëgimet përkatëse.

Mjetet e nevojshme: Kompjuter, Programi Microsoft Excel 2007, Projektor.

Fjalë kyç: Grafik, Tip grafiku, Titull grafiku.

Metoda : E/E/R

Hapi i parë: Evokim

Pyeten nxënësit nëse i kanë përdorur në punët e tyre grafikët.

Mësuesi në këtë fazë të mësimit duhet të sqarojë se çfarë roli luan paraqitja grafike në prezantimin e një pune.

Përpara se të kalojë në ndërtimin e grafikut, mësuesi duhet të shfaqë modele të ndryshme të grafikëve të realizuar me tematika të ndryshme, që nxënësi të kuptojnë rëndësinë e përdorimit të tyre, si dhe fushat në të cilat janë më të pranishëm.

Hapi i dytë: Realizmi i kuptimit

- Koncepte të reja: Paraqitja grafike e të dhënave duke u bazuar në elementin: Kolonë dhe Rresht.
- Tipi i grafikut, na mundëson të zgjedhim në tërësinë e modeleve atë që evidenton më mirë të dhënat tona.
- Vendosja e grafikut. Opsioni që na jep mundësi që ta paraqesim grafikun në të njëjtën faqe me të dhënat, ose të zgjedhim një faqe të re.
- Që një grafik të jetë i kuptueshëm, duhet të shoqërohet me Emërtimet përkatëse.
- Njohja me të dhënat e seksionit Labels (Emërtimet).

Për të gjithë konceptet e reja të dhëna gjatë fazës së realizimit, mësuesi bën demonstrimin e njohurive dhe monitoron veprimtarinë e nxënësve.

Hapi i tretë: Punë e pavarur

Për realizimin e kësaj veprimtarie nxënësit i lihen rreth 35 minuta në dispozicion.

Mësuesi mund ta organizojë me grupe punën, në formën e një konkursi për të parë realizimin më të mirë grafik.

Ide për mësuesin: Nxënësit mund të ndërtojnë një grafik bazuar në raportin djem dhe vajza në klasë.

Pëfundime:

Nxënësit duhet të diskutojnë rreth paraqitjeve grafike të realizuara. Në mënyrë të veçantë duhet të nxitet vlerësimi rreth punës: si u organizuan të dhënat, çfarë synohet të realizohet përmes paraqitjes grafike të tyre, cila prej paraqitjeve është më interesante dhe përse?
(Bar graph, Line graph, Pie chart)

Vlerësimi:

Niveli i lartë: Grafiku është ndërtuar mbi të gjithë kriteret e përcaktuarara.

Niveli i mesëm: Grafiku ka mangësi në disa prej emërtimeve/ose nuk është zgjedhur tipi i duhur.

Niveli i ulët: Grafiku është punuar dobët/ është i paqartë/nuk është zgjedhur grafiku i duhur.

LËNDA: Informatikë I I

TEMA: Formatimi i faqes së punës. Komanda Print Preview, Print.

Koha e zhvillimit: 2orë

Vendi i zhvillimit: Laborator

Objektivat: Në fund të orës së mësimi nxënësi të jetë i aftë:

1. Të identifikojë elementët kryesorë që realizojnë printimin e një materiali në programin Microsoft Excel.
2. Të printojë një material të punuar në Microsoft Excel, duke zbatuar komandat edhe udhëzimet e dhëna nga mësuesi.
3. Të printojë në mënyrë të pavarur një punim të plotë në Microsoft Excel dhe të shpjegojë qartë procedurën e ndjekur.

Mjetet e nevojshme: Kompjuter, Programi Microsoft Excel 2007, Projektor.

Metoda: E/E/R

Hapi i parë: Evokim

Rikujtohen hapat që ndiqen për të printuar një material në Word.

Meqenëse ka komanda të ngjashme, por ndryshime në faqen e punës, mësuesi mund të bëjë njohjen me konceptet e reja duke krahasuar të përbashkëtat dhe dallimet e printimit të një materiali në Word dhe Excel.

Hapi i dytë: Realizmi i kuptimit

- Koncepte të reja: Formatimi i faqes së punës në Excel sipas parametrave të kërkuar.
- Verifikimi i materialit për shtyp si një moment shumë i rëndësishëm.
- Zgjedhja e opsionit të duhur kur japim komandën Print.

Për të gjithë konceptet e reja të dhëna gjatë fazës së realizimit, mësuesi bën demonstrimin e njohurive dhe monitoron veprimtarinë e nxënësve.

Hapi i tretë: Punë e pavarur

Në pjesën e parë të orës mësuesi mund të realizojë një minitest prej 20 minutash, duke kontrolluar shkallën përvetësimit të njohurive.

Ja disa pyetje për një MINITEST?

1. Nëse do të donit të bënit ndryshimin e paraqitjes në shtyp, në krahasim me faqen normale të punës cilin prej opsioneve do të zgjidhnit në seksionin **Page Setup**?
 - a. Page Orientation
 - b. Adjust to
 - c. Scaling
 - d. Fit to

2. Nëse do të dëshironim të vendosim një teskt në fund te faqes së punës në Excel, cili opSION do ta realizonte atë:
 - a. Header
 - b. Footer
 - c. Top
 - d. Botoom

3. Kur një tabelë e kemi vijëzuar vetë, cili prej opsioneve në zonën **Print** nuk duhet të zgjidhet nga ne:
 - a. Black and White
 - b. Gridlines
 - c. Page Order

Pjesa tjetër e orës së mësimi duhet të realizohet si një veprimtari praktike, përmes printimit të një materiali në Excel.

Vlerësimi:

Për vlerësimin mësuesi duhet të marrë parasysh treguesit e minitestit dhe realizimin praktik të detyrës.

LËNDA: Informatikë I I

TEMA: Konceptet bazë të programit Access

Kohëzgjatja: 1 orë

Vendi i zhvillimit: Laborator

Qëllimi i orës së mësimi:

- Familjarizimi nxënësve me versionin Access 2007.

Objektivat: Në përfundim të orës së mësimi nxënësi të jetë i aftë:

1. Të kuptojë rëndësinë e organizimit të të dhënave në një databazë.
2. Të dallojë fushat sipas llojit të tipit të të dhënave që mbartin.
3. Të veçojë nga tërësia e të dhënave çelësin primar.

Mjetet e nevojshme: Kompjuter, Microsoft Access 2007, Fletë pune/Projektor.


Fjalë kyç: Fushë, Të dhëna.

Hapi i parë: Hartë mendimi

Si mund të veprojmë për një organizim sa më efikas dhe të saktë të dhënash?

Për të nxitur debatin, mësuesi shfaq një databazë të gatshme, të plotësuar dhe kërkon mendim nga klasa për organizimin e saj si dhe për informacionin që mund të vjelin prej saj.

Të gjitha mendimet e nxënësve shënohen në formën e një harte mendimi.



Në përfundim të kësaj veprimtarie mësuesi duhet të synojë që të arrihet në një përfundim të përbashkët mbi rolin dhe rëndësinë e përdorimit të databazës.

Hapi i dytë: Prezantimi koncepte të reja

- Fusha e të dhënave.
- Veçoritë e fushës: gjatësia, tipi (numerik, karakter).
- Llojet e skedarëve: Skedar i shtrirë, në formën e tabelës dydimensionale.
- Ç'është një çelës primar?
- Përse na ndihmon çelësi primar?
- Llojet e çelësit primar: Auto number, Singel field, Multiple field.
- Roli i indeksit si strukturë ndihmëse. Çfarë përmban indeksi?

Reflektimi: Punë e pavarur

Mësuesi mund të organizojë një minitest për të parë si është realizuar përvetësimi i njohurive.

MINITEST

Emri _____ Data _____

Databaza është organizim të dhënash. Organizimi i tij në kompjuter lehtëson mbajtjen dhe nxjerrjen e informacionit. Një model database ju është dhënë më poshtë:

Nurmri studentit.	Emri	Mbiemri	Data e lindjes	Indeks
2312	Anisa	Zaimi	19/12/90	RYA
2344	Ana	Dielli	23/06/91	TBL
2367	Eva	Bajo	12/09/90	AGI
2380	Gent	Krasta	09/01/91	TBR
2345	Teuta	Liburni	23/09/92	LFU
2381	Yllka	Eltari	01/01/92	HKN

1. Sa rekorde janë paraqitur? _____ I pikë
2. Sa fusha janë paraqitur? _____ I pikë
3. Cila fushë shërben si çelës në këtë bazë të dhënash?
_____ I pikë
- 4.) Emërto dy fusha të tjera që mund t'i shtosh kësaj databaze ?

_____ I pikë
- 5, Cila prej fushave në databazë ka një të dhënë të tipit numër?
_____ I pikë
6. Çfarë tipi të dhënash përfaqëson fusha Indeks?
_____ I pikë
7. Databazat mbajnë informacion të natyrave të ndryshme. Jep 2 shembuj databazash duke i emërtuar p.sh., - Biblioteka e shkollës.

_____ I pikë
8. Listo dy avantazhe të përdorimit të databazës për ruajtjen e informacionit. 2 pikë

Pikët

LËNDA: Informatikë I I

TEMA: Njohja me elementet e Databazës

Vendi i zhvillimit: Laborator

Qëllimi i orës së mësimi:

- Përdorimi i elementeve të databazës në shërbim të organizimit të informacionit në fusha të ndryshme të veprimtarisë.

Objektivat: Në përfundim të orës së mësimi nxënësi të jetë i aftë:

1. Të aktivizojë dritaren e punës për krijimin e një databaze dhe të identifikojë elementet kryesorë të saj.
2. Të organizojë fushat duke pasur parasysh përpunimet dhe rezultatin që do të marrim prej tyre.
3. Të kompozojë një mini-databazë në mënyrë të pavarur duke respektuar të gjitha kriteret e përcaktuara nga mësuesi.

Mjetet e nevojshme: Kompjuter, Microsoft Access 2007,

Hapi i parë: Prezantimi i koncepteve të reja

- Si mund të aktivizojmë faqen e punës në Microsoft Access?
- Elementet kryesorë në dritaren e databazës.
- Komandat e krijimit të tabelave/formave/pyetjeve (querive)/makrove.
- Ndërtimi i databazës mbi synime të caktuara, duke pasur parasysh rezultatin që do të marrim dhe përpunimet që do të realizojmë me të.
- Fjalori i të dhënave.

Hapi i dytë: Punë e udhëhequr

Me ndihmën e projektorit mësuesi demonstron për nxënësit të gjitha hapat e aktivizimit të një faqeje pune në Microsoft Access.

Secili prej elementeve veçohet dhe kërkohet, që të njëjtën procedurë, nxënësit ta zbatojnë në postet e tyre të punës.

Paralelisht punohet edhe me tekstin.

Për të ndërtuar Fjalorin e të dhënave, mësuesi kërkon nga nxënësit që fillimisht të bëjnë një lexim të kujdesshëm, të rubrikës teorike dhe më pas kalon në demonstrimin konkret.

Këshillohet që të jepet për demonstrim, shembulli i përdorur në tekst, në mënyrë që nxënësi të mos ketë informacion të ngjeshur për konceptet e reja.

Reflektimi: Punë e pavarur

Nxënësi punon me veprimtarinë praktike të tekstit.

LËNDA: Informatikë I I

TEMA: Krijimi i strukturës së tabelës Databazë

Koha e zhvillimit: 2orë

Vendi i zhvillimit: Laborator

Qëllimi i orës së mësimi:

- Aftësimi për të krijuar tabela si pjesë e strukturës së Databazës.

Objektivat: Në përfundim të orës së mësimi nxënësi të jetë i aftë:

1. Të identifikojë elementet e strukturës së bazës së të dhënave.
2. Të modifikojë strukturën e bazës së të dhënave.
3. Të organizojë në mënyrë të pavarur një bazë të dhënash.

Mjetet e nevojshme: Kompjuter, Microsoft Access 2007, Minitest.

Hapi i parë: Prezantim i koncepteve të reja

- Mësuesi fillimisht duhet të shpjegojë se cili është roli i tabelës në krijimin e një databaze.
- Nga nxënësit duhet të kërkohet të rikujtojnë njohuritë e marra në orën e kaluar duke u ndalur te Fjalori i të dhënave, sepse shërben si bazë për plotësimin e tabelës.
- Demonstrimet me ndihmën e projektorit menuja **Create**→**Table design**.
- Në përfundim të plotësimit të tabelës, mësuesi kërkon që nxënësit të ruajnë punën e kryer.

Hapi i dytë: Punë e udhëhequr

Çfarë synojmë të realizojmë me modifikimet që do t'i bëjmë tabelës?

Nxënësi duhet të hapë në kompjuter tabelën e emërtuar **KLIENTI** (nëse ka ruajtur një tabelë të emërtuar ndryshe punon me të)

Për të zgjedhur tabelën e duhur për punë, mësuesi **duhet të evidentojë** rolin e butonit **Design Views**.

Fillimisht shënohen në tabelë modifikimet që do të provojmë të realizojmë, p.sh.: ndryshim i parametrave, që tashmë janë të deklaruar në tabelë, shtim fushash, heqje të tyre etj.

Të gjitha veprimet e mësipërme zhvillohen në të njëjtën kohë për të gjithë klasën.

Mësuesi duhet të krijojë ndalesa nga një veprim te tjetri dhe demonstrimi të bëhet përmes punës së nxënësve.

Hapi i tretë: Punë e pavarur

Duke u nisur nga njohuritë e orës së parë, mësuesi zhvillon veprimtari praktike në grupe.

Secili grup duhet të përfshijë nxënës të niveleve të ndryshme.

Për organizimin e të dhënave nxënësit mund të ndjekin rrugë të ndryshme.

Indeksi i regjistrimeve, modifikimi i tyre, shtimi, fshirja etj.

Mund të përdoren për veprimtari praktike ushtrimet e teksit ose të jepen modele ushtrimesh të realizuara nga mësuesi.

MINITEST - Të matim njohuritë mbi krijim e strukturës së një Database

- a. Listo tri mënyra për të realizuar modifikimin e një Database dhe jep për secilën nga një shembull:

- b. Cilat janë dy metodat për të zëvendësuar tekstin në një databazë?
- c. Emërto dy opsionet e menisë View, që përdoren për të organizuar një Databazë.
- d. Përshkruaj me nga një fjali të shkurtër proceset që përdoren për mbledhjen dhe vendosjen e të dhënave në një databazë.

LËNDA: Informatikë I I

TEMA: Koncepti dhe krijimi i një forme.

Vendi i zhvillimit: Laborator

Qëllimi i orës së mësimi:

- Të fitojnë shprehi në përdorimin e formave si një rrugë mjaft komode për regjistrimin e të dhënave.

Objektivat: Në përfundim të orës së mësimi nxënësi të jetë i aftë:

1. Të identifikojë llojet të ndryshme të formave (columnar, tabular, datasheet).
2. Të dallojë format për nga avantazhet që ofrojnë në përdorim.
3. Të realizojë në mënyrë të pavarur regjistrimin e një grupi të dhënash, në një prej formave që ofron programi.

Mjetet e nevojshme: Kompjuter, Microsoft Access 2007, Projektor.

Hapi i parë: Diskutim

- Çfarë na ofron përdorimi i Formave?

Me atë grupim të nxënësve që mund të kenë dije rreth përdorimit të tyre, mësuesi duhet të synojë në arritjen e dy-tre përfundimeve në lidhje me përdorimin e formave.

Komunikimi mjaft i lehtë me përdoruesit.

Hapi i dytë: Punë e udhëhequr

- Me ndihmën e projektorit mësuesi demonstron menunë kryesore **Create, More Forms**. E hapim dhe zbatojmë **Form Wizard**
- Gjatë demonstrimit është tepër e rëndësishme, që nga mësuesi të bëhet dallimi midis të gjithë attributeve të tabelës për të cilën do të ndërtohet Forma si dhe atributetet që do të shërbejnë për krijimin e formës.
- Për të kuptuar nga dallojnë nga njëra-tjetra, mësuesi duhet t'i demonstrojë të gjitha llojet e formave, jo vetëm modelin e dhënë në libër (datasheet).
- Pasi ka kryer gjithë procedurën e mësipërme së bashku me nxënësit, duhet të emërtojë formën që sapo krijoi.
- Në tekstin tuaj, duke ju referuar të dhënave që u regjistruan në të, ajo është quajur **KLIENTI**. Emërtimi i saj duhet të jetë i lidhur me informacionin e futur në të.
- Edhe me format mund të realizojmë një sërë modifikimesh.

Reflektimi: Punë e pavarur

Zhvillohet veprimtaria praktike e parashikuar në libër. Puna duhet të realizohet në grup.

Përveç demonstrimit praktik, është e nevojshme të tregohen përmes rregullave të gjithë hapat e ndjekur.

LËNDA: Informatikë I I

TEMA: Koncepti dhe krijimi i një querie të thjeshtë

Kohëzgjatja: 2 orë

Vendi i zhvillimit: Laborator

Objektivat: Në përfundim të orës së mësimi nxënësi të jetë i aftë:

1. Të krijojë queri të thjeshta mbështetur në të dhënat e tabelave të krijuara në orët e mëparshme.
2. Të aplikojë në ndërtimin e querve kritere komplekse për marrjen e informacionit të shumëllojshëm.
3. Të kompozojë në mënyrë të pavarur queri, duke përdorur kombinime të kritereve të ndryshme, bazuar në fushat e të dhënave, që kërkojnë zbatimin e sintaksave të ndryshme.


Mjetet e nevojshme: Kompjuter, Microsoft Access 2007, Projektor.

Fjalë kyç: Queri

Metoda: E/E/R

Hapi i parë: Evokim

Rikujtesë: Çfarë është një databazë? Nxënësi përmes një stuhie mendimi duhet të evidentojë disa nga përgjigjet e mëposhtme.



Një koncept tjetër i rëndësishëm me të cilin nxënësit janë njohur në orët e mëparshme është ai mbi Format.

Duhet të vihet theksi në faktin se ato dizenohen nga përdoruesi për të lehtësuar punën për hedhjen e të dhënave.

Hapi i dytë: Realizimi i kuptimit

- Mësuesi jep në tabelë, në formën e përkufizimit, se çfarë përfaqësojnë queri-të në programin Microsoft Access

Queri lejojnë përdoruesit të selektojnë informacionin e zgjedhur nga një tabelë apo shume tabela.

- Për të demonstruar praktikisht krijimin e një querie, mësuesi zgjedh një databazë të thjeshtë të punuar në orët e mëparshme nga nxënësit.

- Krijimi i queri nënkupton marrjen e disa fushave të një tabele, këtu mësuesi duhet të japë shpjegimin se zgjedhja e fushave nga një tabelë, për krijimin e queri bëhet në funksion të informacionit që duam të marrim në përfundim.
- Për querin e thjeshtë, mësuesi aplikon një kriter të vetëm.
- Nëse do të demonstrohet tabela e dhënë si model në tekstin mësimor Informatika II, atëherë kriteri i vetëm do të jetë seleksionimi mbi bazën e qytetit prej nga vijnë klientët - Durrës.
- Mësuesi rekomandohet që për grupin e nxënësve të avancuar, të kërkojë kombinimin e kriterëve të ndryshme.

Reflektimi: Punë e pavarur

Në 45 minuta u jepet mundësia nxënësve të punojnë me veprimtarinë praktike të tekstit.

Nxënësit e nivelit të lartë, rekomandohet të punojnë me një bazë të dhënash të krijuar nga ata vetë.

LËNDA: Informatikë I I
TEMA: Përgatitja e raporteve

Kohëzgjatja: 1 orë

Vendi i zhvillimit: Laborator

Qëllimi i orës së mësimi:

- Shfrytëzimi i informacionit të punuar në Microsoft Access në mënyrë sa më efektive dhe tërheqëse.

Objektivat: Në përfundim të orës së mësimi nxënësi të jetë i aftë:

1. Të identifikojë raportet si një mjet shumë i rëndësishëm për nxjerrjen e informacionit nga programi Microsoft Access.
2. Të përdorë raporte në mënyrë që të bëjë një paraqitje sa më tërheqëse dhe estetike të informacionit të përpunuar në Microsoft Access.
3. Të hartojë në mënyrë të pavarur raporte bazuar në tabelat ose queri, duke shfrytëzuar punët e krijuara në mënyrë vetjake.

Mjetet e nevojshme: Kompjuter, Microsoft Access 2007, Projektor.

Fjalë kyç: Raport

Metoda: E/E/R

Hapi i parë: Të menduarit në mënyrë kritike

Në orët e mëparshme nxënësit janë njohur me përdorimin dhe ndërtimin e querive.


Zbatimi i metodës së krahasimit i nxit ata të mendojnë në mënyrë kritike duke vënë përballë konceptet më të përbashkëta dhe dallimet.

Fillimisht mësuesi shkruan në tabelë fjalën kyç Raport.

Mësuesi **nuk duhet** të japë përkufizime direkte, sepse në këtë mënyrë do të pengonte procesin e të menduarit të nxënësit.


Mësuesi shfaq me ndihmën e projektorit një queri dhe një raport të gatshëm. (shembulli mund të jetë ai i trajtuar në tekst, por mund të jetë edhe i ndryshëm).

QUERI



VideoID	Title	Certificate
9	Absolute Beginners	15
32	As Good As It Gets	15
3	Blade Runner	15
6	Crocodile Dundee	15
15	Elephant Man, The	15
24	Every Which Way but Loose	15
25	Eyes of Laura Mars	15
12	Fatal Attraction	15
22	Guilty by Suspicion	15
20	It Lives Again	15
10	Private Benjamin	15
23	Runaway Jury	15
26	Shakespeare in Love	15
36	Terminator 2 Judgement Day	15
5	The Shining	15
28	The Transporter	15
39	Transporter 2	15


RAPORT



VideoID	Title	Certificate
9	Absolute Beginners	15
32	As Good As It Gets	15
3	Blade Runner	15
6	Crocodile Dundee	15
12	Fatal Attraction	15

Nnënësi duhet të kuptojë jo vetëm ndryshimet në paraqitje, por në mënyrë të veçantë faktin se për të ndërtuar **një raport** duhet më parë të ketë ndërtuar një **queri**. Mësuesi mund ta bëjë demonstrimin me ndihmën e një nxënësi me njohuri të avancuara në Micorsoft Access.

Të gjitha komandat që zbaton mësuesi i shënon në tabelë me një diagramë hierarkike. P.sh.,



Në përfundim të kësaj veprimtarie mësuesi ndalon te koncepti i **Renditjes së regjistrimeve**. Edhe njëherë tërhiqet vëmendja për përcaktimin e **Kritereve**. Në shembullin e tekstit Informatika I I, ky kriter është **Data e Dorëzimit**.

Hapi i dytë: Punë e udhëhequr

Gjatë fazës së parë nxënësit së bashku me mësuesin bënë parapërgatitjen e raportit.

Njohën dhe u kuptuan komandat e nevojshme për krijimin e tij.

Është tepër e rëndësishme nga ana e mësuesit, që të theksohet fakti se në Raport në dallim nga Queri është e mundshme të shtohen:

- Një titull i përshtatshëm për informacionin.
- Një figurë, nëse duam ta ilustrojmë me një të tillë.
- Emrin tonë, nëse duam ta japim si burim etj.

Pikërisht në punën e udhëhequr, mësuesi duhet të demonstrojë këtë fazë të përgatitjes së raportit deri në fazën e printimit.

- Faqosja:** Kemi një ripërsëritje të koncepteve në lidhje me orientimin e faqes së punës si dhe në programet e tjera.
- Kurse përta i përket paraqitjes, në menu gjejmë tri variante.
- Zgjedhja e stilit:** Këtu i kushtohet vëmendje një sërë formatimesh dhe na ndihmojnë edhe modelet e gatshme.
- Zgjedhja e titullit:** Është një tjetër opsion që na ofrohet, ku ne vendosim titullin që duam.
- Pëdorimi i Design View për të bërë ndryshime në shkrim, vijëzim etj.

Hapi i tretë: Veprimtari praktike e pavarur

Shfrytëzohet rubrika Veprimtari praktike e librit.

Në tekst janë dhënë tri pyetje. Mësuesi e ndan klasën në tri grupe dhe secili grup ndërton një raport.

Kjo fazë e orës së mësimi mund të konceptohet si një konkurs, duke shpallur fitues grupin që ka hartuar më shpejt, më saktë, më bukur estetikisht **Raportin**.

LËNDA: Informatikë I I

TEMA: Veprimet kryesore në objektet e Access, Filtrimi.

Kohëzgjatja: 1 orë

Vendi i zhvillimit: Laborator

Objektivat: Në përfundim të orës së mësimit nxënësi të jetë i aftë:

1. Të veçojë disa nga veprimet kryesore në objektet e Microsoft Access.
2. Të kryejë në përshtatje me informacionin që synon të evidentojë, disa prej veprimeve kryesore në objektet e Access.
3. Të zbatojë në mënyrë të pavarur kritere të ndryshme renditjeje.

Mjetet e nevojshme: Kompjuter, Microsoft Access 2007, Projektor.

Fjalë kyç: Renditje, Renditje me dy kritere, Filtrat në tabela.

Metoda: E/E/R

Hapi i parë: Evokim

Renditni disa avantazhe që mendoni se ju ofron përdorimi i databazave.

Synimi i pyejtjes është jo thjesht të masë njohuritë e nxënësve në lidhje me fushat ku përdoren databazat.

Mësuesi synon të nxisë të menduarit për përdorimin e tyre, në funksion të organizimit të informacionit.

Hapi i dytë: Realizimi i kuptimit

Mësuesi liston në tabelë veprimet kryesore që kryen në objektet e Access.

- | | |
|-----------------------------------|------------------------------------------------|
| I. Renditje | Çfarë sigurojmë përmes renditjes? |
| II. Renditje sipas dy kritereve | Nga dallon ajo nga renditja e zakonshme? |
| III. Filtra në tabelë | Vendosja e kushteve në lidhje me vizualizimin. |
| IV. Heqje e renditjes dhe Filtrit | Si realizohet? |

Për secilin veprim mësuesi realizon demonstrim praktik, e shfaq me ndihmën e projektorit dhe kërkon që nxënësit të përsëritin veprimin në kompjuterat e tyre.

Mësuesi monitoron kryerjen dhe realizimin e kësaj faze të orës së mësimit.

Hapi i tretë: Punë e pavarur

Nxënësi punon me rubrikën Veprimtari praktike.

Gjithashtu mësuesi në përfundim të kësaj ore mund të realizojë një minitest me njohuri të përgjithshme mbi Microsoft Acces

MINITEST

- I. Një databazë është i ndarë në:
 - a. Recorde
 - b. Fusha
 - c. Artikuj
 - d. Emra

2. Në një databazë me artikuj gazetash, revistash secili rekord paraqet:

- a. Një autor
- b. Një artikull nga gazeta/revista
- c. Të gjitha së bashku

3. Në një databazë me artikuj gazetash, revistash fusha e secilit rekord paraqet

- a. Emrin e autorit
- b. Titullin e artikullit
- c. Emrin e gazetës/revistës
- d. Të gjitha së bashku

4. Ju jeni duke krijuar databazën tuaj, ku do të organizoni të dhënat mbi 100 filmat më të pëlqyer. Ju dëshironi të përfshini në të, të dhënat e mëposhtme: titulli, aktorët, regjisori, viti i prodhimit, lloji i filmit.

Secili rekord në databazën tuaj do të përfaqësojë:

- a. Një aktor
- b. Një regjisor
- c. Një vit
- d. Një film

5. Ju jeni duke kërkuar indeksin e një artikull në Internet, duke iu referuar një citimi nga gazeta/revista. Cila pjesë e artikullit mendoni se është pëfshirë në databazë?

- a. I gjithë artikulli
- b. Përmbledhja e tij
- c. Titulli i artikullit
- d. Autori, titulli dhe burimi

25 CD MUZIKORE MË TË KËRKUARA MICROSOFT ACCESS DATABASE PROJEKT

Përshkrimi i Projektit

Në Microsoft ACCESS krijoni një database me 25 CD muzikore më të kërkuara në treg. Merrni këtë informacionin nga kërkimi në Internet. Listoni të gjitha sitet e përdorura në një dokument në WORD. Listimin e tyre bëjeni në rend alfabetik.

Në databazë përfshini fushat e mëposhtme:

- Artisti
- Titulli
- Studio regjistruese
- Vlera monetare (jo më e vogël se 1000 lekë)
- Çmimet e marra
- Lloji (kategoria-p.sh. Rock, Country, R & B, etj.)
- Data e prodhimit

Pasi të keni krijuar databasë-n, sortoni në rendin zbritës sipas titullit.

Printoni një kopje të këtij materiali. _____ 25 pikë

Krijoni një queri ku të listoni të gjitha CD me vlerë 1200 lekë ose më të madhe.

Ruajeni querin dhe printoni një kopje. _____ 25 pikë

Duke përdorur Report wizard, krijoni një raport me modelin tabular, në të cilin listoni sipas Titullit, Artistit, Llojit, Data e prodhimit duke sortuar sipas preferencës suaj.

Ruajeni dhe printojenin një kopje në orientimin landscape. _____ 25 pikë

TOTALI PIKËVETË FITUARA (75 pikë të mundshme) _____

LËNDA: Informatikë I I

TEMA: Llojet e rrjetave kompjuterike

Kohëzgjatja: 1 orë

Vendi i zhvillimit: Laborator

Qëllimi i orës së mësimit:

- Familjarizimi me terminologjinë e networkut.

Objektivat: Në përfundim të orës së mësimit nxënësi të jetë i aftë:

1. Të identifikojë dhe të përshkruajë terminologjinë e networkut bazuar në të përbashkëtat dhe dallimet mes tyre.
2. Të klasifikojë llojet e rrjetave duke iu referuar karakteristikave të ndërtimit të tyre.
3. Të njerrë përfundime vetjake mbi kuptimin e intranetit dhe ekstranetit.

Mjetet e nevojshme: Kompjuter, Internet, Skema rrjetesh, Projektor.

Fjalë kyç: LAN, WAN, ITRANET, EKSTRANET

Metoda: E/E/R


Hapi i parë: Evokim

Mësuesi tërheq vëmendjen e nxënësve, të sjellin mendimin e tyre se si funksionojnë kompjuterat e tyre në laborator dhe çfarë lidhjeje kanë ata me kompjuterin e mësuesit.

Synohet të dilet në konceptin e **Rrjetit, faktin që ata mund të shkëmbejnë informacion me njëri-tjetrin, mësuesi ka akses të ndërhyjë gjatë veprimtarive të tyre që nga kompjuteri i tij etj.**

Për të evidentuar arsyet e përdorimit të kompjuterave në rrjet mësuesi shtron për klasën pyetje:

Cilat janë sipas jush përparësitë e përdorimit të një rrjeti kompjuterash?



Hapi i dytë: Realizimi i kuptimit

Prezantimi i koncepteve të reja: Rrjeta të Zonës Lokale (**Local Area Network, LAN**), Rrjeta Metropolitane, Rrjeta Mbarëzonale, (**Wide Area Network, WAN**)


Për secilën prej llojeve të rrjetave mësuesi duhet të shfaqë me ndihmën e projektorit, skemën e funksionimit të saj

Në paraqitjen e rrjetit LAN, mësuesi ndalet në konceptet: **host, sever, gateway**, duke demonstruar praktikisht si realizohet lidhja mes tyre.

Është tepër e rëndësishme që **mësuesi të listojë në tabelë**, disa nga veçoritë e rrjetave LAN (janë në zotërim të plotë të një institucioni/organizate etj)

Duke prezantuar rrjetin WAN, mësuesi bën dallimin me rrjetin LAN.

VËSHTRIMI KRAHASUES MUND TË BËHET NË TABELË ME NDIHMËN E DIAGRAMËS SË VENNIT.



Hapi i tretë: Punë e udhëhequr

Në këtë fazë, mësimi mund të realizohet edhe në klasë. Mund të punohet me libër përpara, meqë autorët e kanë shoqëruar shpjegimin e koncepteve me skemat përkatëse.

Mësuesi duhet të synojë që nxënësit t'i përvetësojnë kuptimet për intranetin dhe ekstarinetin, përmes të menduarit në mënyrë kritike.

Në mënyrë të veçantë duhet të stimulohet të pyeturit.

1. Ç'përfaqësojnë Intraneti dhe Ekstraneti?
2. Ku gjejnë përdorim ata?
3. Ku dallojnë nga njëri-tjetri?

Punë e pavarur:

Mësuesi teston njohuritë e përvetësuara nga nxënësi duke shfrytëzuar rubrikën e tekstit **Provoni njohuritë**

Vlerësimi:

Duke u nisur nga shkalla e realizimit të objektivave të vëna në fillim të orës së mësimi, që u përkasin edhe tri niveleve të arritjes, mësuesi bën vlerësimin për nxënësit në përfundim të orës së mësimi.

Theksojmë se mësuesi duhet të bëjë të qartë për nxënësin se çfarë kopetencash dhe në cilën shkallë paraqitet zotërimi i njohurive nga ana e tij.

LËNDA: Informatikë I I
TEMA: Lundrimi në Internet

Kohëzgjatja: 1 orë

Vendi i zhvillimit: Laborator

Qëllimi i orës së mësimi:

- Aftësimi nxënësve në përdorimin e mjeteve të teknologjisë së informacionit për të kërkuar dhe pasuruar informacionin e tyre nëpërmjet shumë burimeve, në kohë sa më të shkurtër. Orientimi i tyre për një lundrim në Internet, të kontrolluar dhe të dobishëm

Objektivat: Në përfundim të orës së mësimi nxënësi të jetë i aftë:

1. Të njohë dhe të diskutojë rreth historikut të lindjes dhe përdorimit të Internetit.
2. Të listojë dhe shpjegojë elementet mbi të cilët ndërtohet WWW.
3. Të lundrojë në mënyrë të pavarur në Internet, duke sjellë informacion mbi motorët e kërkimit, postën elektronike etj.

Mjetet e nevojshme: Kompjuter, Internet, Projektor.

Fjalë kyç: WWW, Internet, address book, Internet service provide, mainframe, modem newsgroup, online service provider, plain text, search engine, server, upload, URL, Archie, browser, dialog box, discussion group, download, e-mail, FAQ, FTP, home page, http, hypertext link, information superhighway

Hapi i parë: Insert

Të gjitha fjalët kyç mësuesi i shfaq të listuara në tabelë.

Ai u jep nxënësve 10-15 minuta kohë dhe kërkon që për secilën prej tyre të japin një shpjegim të shkurtër, (gjithmonë të bazuar në dijet e tyre).

Terminologjia	Shpjegimi
URL	tregon një adresë interneti të një skedari të vendosur në një host të lidhur në Internet.
Home page	
Address book	

Ky ushtrim nuk ka vlerë kontrolluese, por i jep mundësinë mësuesit të përqëndrohet mbi atë pjesë të njohurive ku nxënësit nuk kanë asnjë mendim vetjak ose janë të paqartë.

Kjo praktikë bën të mundur që nga një informacion tepër i ngjeshur, që ka kjo orë mësimi, nxënësi të bëjë diferencën mes njohurive që njeh dhe koncepteve tërësisht të reja ose të panjohura.

Hapi i dytë: Punë e pavarur

Gjatë rubrikës së parë është realizuar dhe shpjegimi i koncepteve të reja dhe demonstrimi i tyre me projektor.

Mësuesi kalon në veprimtari praktike duke përdorur në formën e Minitestit pyetjet e mëposhtme:

1. Listo 3-5 nga motorët kryesorë të kërkimit.

1. _____

2. _____

3. _____

4. _____

5. _____

2. Gjej temperaturën më të lartë dhe më të ulët në tri kryeqytete europiane

Shkuaj URL _____

3. Nëse dëshironi të shihni se cilat faqe keni shfletuar gjatë kësaj ore mësimi, në cilin buton do të klikonit?

4. Ju dëshironi që të dërgoni një e-mail te më shumë se një person. Kushti juaj është që adresa e tyre e e-mailit të mos shihet. Cilën fushë do të përdornit për këtë rast CC apo BCC

5. Jep të paktën tri emërtime skedarësh që mund t'i bashkangjitem një e-maili

a. _____

b. _____

c. _____

Vlerësimi:

Niveli i lartë: Nxënësi i është përgjigjur saktë pyetjeve të minitestit, ka marrë pjesë aktivisht gjatë gjithë orës së mësimit. Ka demonstruar pavarësi në kryerjen e veprimeve.

Niveli i mesëm: Nxënësi i është përgjigjur sakt 80% të pyetjeve të minitestit.

Ka provuar të japë mendime vetjake gjatë orës së mësimit dhe ka plotësuar idetë e tij me ndihmën e mësuesit.

Niveli i ulët: Nxënësi i është përgjigjur sakt 50% të pyetjeve të minitesit. Nuk ka marrë pjesë në mënyrë aktive gjatë orës së mësimit. I mungon pavarësia e mendimit.

LËNDA: Informatikë II

TEMA: Siguria e punës në Internet

Kohëzgjatja: 1 orë

Vendi i zhvillimit: Laborator

Qëllimi i orës së mësimi:

- Nxënësit të diskutojnë rreth vlerave të internetit dhe rrugëve për ta bërë përdorimin e tij të sigurtë dhe të dobishëm në përdorimin e sajteve sociale.

Objektivat: Në përfundim të orës së mësimi nxënësi të jetë i aftë:

1. Të identifikojë dhe të klasifikojë disa prej standarteve që sigurojnë punën në Internet.
2. Të përdorë opsionet që e bëjnë punën e tij në internet të sigurtë nga faqet e pakontrolluara dhe pirate.
3. Të konfigurujë në mënyrë të pavarur opsionin Family Safety Control Panel duke vendosur ndalime të ndryshme etj.

Mjetet e nevojshme: Kompjuter, Windows Vista, Internet, Projektor.

Fjalë kyç: ICANN, ISTF

Teknika e përdorur: TË MENDUARIT KRITIK

Hapi i parë: Diskutim

Mësuesi paraqet me ndihmën e projektorit pamjen e dy kompjuterave që komunikojnë me njëri -tjetrin. Nxënësit duhet të eksplorojnë përmes ideve të tyre rëndësinë dhe përgjegjësitë që lindin nga përdorimi i internetit.

Objekt i këtij diskutimi duhet të bëhen disa prej termave të mëposhtëm: chat rooms blogs, e-mali, including the Internet – chat rooms, blogs, social websites and e-mail.

Do të rekomandonim që mësuesi t'i jepte këtij momenti të orës së mësimi formën e një debati **Pro dhe Kundra**, duke e ndarë klasën në 2 grupe: rrezikshmërisë dhe dobishmërisë së përdorimit të Internetit.



Pyetjet mbi të cilat mund të zhvillohet debati:

- A jeni përdorues të MySpace ose Face Book?
- A chatoni me të panjohur?
- Sa kohë shpenzoni në Internet?

Debati duhet të bazohet në mënyrë të veçantë mbi eksperiencat personale.

Hapi i dytë: Realizimi i kuptimit

Prezantimi i opsioneve të Windows Vista për të vendosur kontroll mbi website të caktuara.

User Account → Parents Controls → Family Safety Control Panel

Bëhet demonstrimi praktik i konfigurimit të kompjuterit, për të penguar shikimin e siteve të padëshiruara.

Windows Vista, na lejon që me ndihmën e dy opsioneve të lartpërmedura, të krijojmë llogari të veçanta për secilin pjestar të familjes dhe të kontrollojmë se cilët website, programe, lojëra ai përdor apo ka instaluar.

Hapi i tretë: Punë e pavarur

Punohet në klasë me kërkesat 1 dhe 2 të Veprimtarisë praktike, në librin Informatika 11.

Klasa ndahet në dy grupe.

Grupi A, ka për detyrë të konfigurojë Internet Option për të bërë sa më të sigurt navigimin në Internet

Grupi B, do të realizojë të vendosë të paktën 2 ndalime në Family Safety Control Panel.

Vlerësimi:

Bazohet në punën në grup, duke marrë parasysh ndërveprimin, shpirtin e skuadrës si dhe cilësitë personale.

LËNDA: Informatikë I I

TEMA: Interneti nëpërmjet linjës telefonike

Kohëzgjatja: I orë

Vendi i zhvillimit: Laborator

Objektivat: Në përfundim të orës së mësimi nxënësi të jetë i aftë:


1. Të kuptojë dhe të shpjegojë funksionin e modemit për të siguruar një lidhje në internet duke shrytëzuar linjën telefonike.
2. Të përshkruajë procedurën e lidhjes me shërbimin e internetit, përmes linjës telefonike.
3. Të realizojë në mënyrë të pavarur lidhjen në internet të një rrjeti LAN (2-4 kompjutera).

Mjetet e nevojshme: Kompjuter, Modem ADSL, Internet

Fjalë kyç: ISP, MODEM, ISDN.

Hapi i parë: Evokim

Mësuesi me ndihmën e projektorit, ose edhe duke shfrytëzuar tekstin tërheq vëmendjen e nxënësve në skemën e mëposhtme.



Nga të gjithë elementet përbërës mësuesi demonstron Modemin.

Ftohen nxënësit që të shprehin njohuritë e tyre rreth kësaj pajisjeje.

Duke qenë se në qytete të caktuara (sidomos në Tiranë), përdorimi i internetit në familje është përhapur gjerësisht, nxënësit mund të kenë njohuri të gjera mbi llojet e ndryshme të Modemeve.

Skema shërben që nxënësi të kuptojë cili është funksioni kryesor i Modemit.

Mësuesi shpjegon si koncept të ri prejardhjen e fjalës **Modem**⇒**Modulim**⇒**Demodulim**.

Hapi i dytë: Realizimi kuptimit

Çfarë përfaqësojnë protokollet *TCP/IP*? Mësuesi duhet të japë në fomën e një përkufizimi çfarë përfaqëson secili prej këtyre protokolleve (**T**ransmission **C**ontrol **P**rotocol/**I**nternet **P**rotocol).

Më pas mësuesi kalon në shpjegimin e pyetjeve të mëposhtme, duke bërë edhe demonstrimin praktik të tyre në kompjuter.

Çfarë roli luan IP address? E gjejmë të shfaqur automatikisht, nëse networku e ka këtë aftësi, në të kundërt duhet të lidhemi me administratorin e networkut për ta marrë këtë të dhënë p.sh 192.168.0.1

Siç e shikoni është një kod numrash që identifikojnë kompjuterin tuaj nga kompjuterat e rrjetit.

Mësuesi duhet të ndalet në shpjegimin e konfliktit që krijonë IP e njëjta.

Gjithashtu duhet të bëjë dallimin mes IP dinamike, e cila ndryshon sa herë ne logojmë dhe IP statike, e cila ngelet gjithmone e njëjta.

Cili është roli i subnet mask? Është një seri numrash që përcaktojnë një IP addresses që përdoret në network. P.sh 255.255.255.0

Cili është roli i një default gateway? Portë e gatshme, që zakonisht është e njëjtë me subnet mask.

Në këtë fazë të mësimit mësuesi kombinon demostrimin praktik me monitorimin e veprimtarisë së nxënësve.

Është e domosdoshme të mos bëhet kalimi nga një procedurë te tjetra pa një kuptim të qartë të elementit paraardhës.

Hapi i tretë:Veprimtari praktike

- Të bëhet konfigurimi i një modemi ADSL dhe lidhja e tij në rrjet me disa prej kompjuterave të laboratorit.
- Kjo veprimtari zhvillohet në grupe. Në një fazë të mëvonshme gjatë orës së praktikës mësuesi mund të kërkojë zhvillimin e veprimtarisë në mënyrë të pavarur.
- Veprimtaria duhet të jetë ushtrimore dhe jo kontrolluese duke pasur parasysh dhe kohën e shkurtër në dispozicion.

KUIZ

1. Çfarë është World Wide Web?
 - a. Një lojë kompjuteri.
 - b. Një program kompjuterik.
 - c. Pjesë e internetit që bën të mundur lidhjen e faqeve përmes shpërndarjes së informacionit.
 - d. Një emër tjetër për internetin.
2. Cili është mjeti më i mirë për të gjetur një Website, që është zgjedhur dhe rekomanduar nga dikush tjetër?
 - a. Subject directories
 - b. Search engines
 - c. Meta-search engines
 - d. Discussion groups
3. Kush e ka zhvilluar për herë të parë Internetin?
 - a. Një haker kompjuterash
 - b. Një korporatë
 - c. Departamenti Amerikan i Mbrojtjes
 - d. Universiteti i Miçiganit
4. Cila nga alternativat e mëposhtme përfaqëson një motor kërkimi?
 - a. Macromedia Flash
 - b. Google
 - c. Netscape
 - d. Librarians' Index to the Internet
5. Çfarë është një URL?
 - a. Një program kompjuterik
 - b. Një tip UFO
 - c. Adresë dokumenti ose faqe në World Wide Web
 - d. Një akronim për Unlimited Resources for Learning
6. <http://www.classzone.com> është shembull i kujt?
 - a. Një URL
 - b. I një kodi aksesi
 - c. Një direktori
 - d. Një server